



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

PSH. Nr.828/23

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 06.11.2023 për tërheqje nga ankesa e parashtruar nga OE KUSHTRIMI NM SH.P.K., me datë 23.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi kanalizimeve fekale ne disa fshatrat të komunës se Gjilanit sipas Lot 1 dhe Lot 2", me numër të prokurimit 651-23-7591-5-2-1, inicuar nga KUVENDI KOMUNAL - GJILAN në cilësinë e autoritetit kontraktues, Paneli Shqyrtues në përbërje nga Vedat Poterqoi, Agon Ramadani dhe Isa Hasani, me 07/11/2023, morrën këtë:

**VENDIM**

- 1. Aprovohet**, kërkesa e datës 06.11.2023, e parashtruar nga KUSHTRIMI NM SH.P.K., për tërheqjen e ankesës me nr. 2023/0828, e datës 23/10/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi kanalizimeve fekale ne disa fshatrat të komunës se Gjilanit sipas Lot 1 dhe Lot 2", me numër të prokurimit 651-23-7591-5-2-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e autoritetit kontraktues.
2. I lejohe, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Gjilan që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi kanalizimeve fekale ne disa fshatrat të komunës se Gjilanit sipas Lot 1 dhe Lot 2", me numër të prokurimit 651-23-7591-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 pika 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës

në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

Operatori ekonomik OE KUSHTRIMI NM SH.P.K. me datën 23.10.2023, ka paraqitur ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi kanalizimeve fekale ne disa fshatrat të komunës se Gjilanit sipas Lot 1 dhe Lot 2”, me numër të prokurimit 651-23-7591-5-2-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Operatori ekonomik KUSHTRIMI NM SH.P.K., me datën 06.11.2023 në sistemin elektronik e-prokurimi ka tërhequr ankesën me numër 2023/0828, e cila është vërtetuar sipas detyrës zyrtare të OSHP.

Me rastin e informimit lidhur me veprimet e përshkruara si më sipër, Paneli Shqyrtues mori vendim për aprovimin e kërkesës për tërheqje nga ankesa duke i lejuar AK që ta vazhdojë aktivitetin e prokurimit (i përshkruar si më sipër) nëse AK nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet. Krahas kësaj po ashtu duhet theksuar se në të tilla raste mungon efekti pezullues i ankesës në kuptim të nenit 112, paragrafi 1, të LPP sipas të cilit dorëzimi i një ankese e obligon AK që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret. Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore në këtë fazë, pa nevojë që të hapet faza e vlerësimit meritior lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, sepse mungon objektivi ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;

Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore para OSHP në këtë fazë dhe lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se:

- a) mungon objektivi ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;
- b) ankuesit, i mungon statusi i palës së interesuar, sipas nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP.

Në këtë rast duhet theksuar se në kuptim të nenit 13, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Kurse në kuptim të nenit 109, paragrafi 1, të LPP, po ashtu parashihet se çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë OSHP. Mirëpo, në kuptim të parimeve bazë të legjislationit, posaçërisht parashikuar me dispozitën e nenit 93 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme administrative, kjo

njëherësh kjo nënkupton faktin se çdo palë e interesuar ka të drejtë po ashtu ta ndryshoj (plotësoj, përmirësoj, precizoj) ankesën dhe po ashtu ta tërheq atë.

Në fakt, Paneli Shqyrtues ka konfirmuar faktin e tërheqjes së ankesës, bazuar në veprimet e palës përmes publikimit të tyre në platformë përkatësisht faqen zyrtare të sistemit të prokurimit publik, prandaj nuk gjeti arsye për të vepruar në kuptim të nenit 110 të LPP andaj janë krijuar kushtet që procedura në këtë çështje juridiko administrative të përfundoj në kuptim të nenit 97 të LPPA. Megjithatë Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK, në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
**Vjosa Gradinaj Mexhuani**  
Kryetare e Panelit Shqyrtues

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

AK- Komuna Gjilan

OE - KUSHTRIMI NM SH.P.K

Arkivës së OSHP-së.